

URDHËR
Nr. 33, datë 25.2.2014

PËR DELEGIM KOMPETENCASH PËR PROCEDURAT E PROKURIMIT PUBLIK

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës, të nenit 27 e në vijim të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Autoritetit Kontraktor, për procedurat e prokurimit publik për Ministrinë e Zhvillimit Urban dhe Turizmit, Sekretarit të Përgjithshëm, z. Robert Gjini.
 2. Këto kompetenca do të ushtrohen deri në datën 31.12.2014.
 3. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm dhe strukturat përgjegjëse për zbatimin e këtij urdhri.
- Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**MINISTRI I ZHVILLIMIT
URBAN DHE TURIZMIT
Eglantina Gjermeni**